Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

04.07.2019, Prishtinë,
Ref:24.04.2019\801-2019

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Vlora Krasniqit kundër portalit Veriu.info

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e tij të mbajtur më 25 qershor 2019, shqyrtoi ankesën e Vlora Krasniqit kundër portalit Veriu.info lidhur me artikullin ”Ekskluzive – Emrat e 32 grave kosovare të ktheyra mbrëmë nga Siria”, dhe mori këtë:

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankesa ka të bëjë me shkrimin e publikuar në portalin Veriu.info e që ka të bëjë me shkrimin "EKSKLUZIVE – emrat e 32 grave kosovare të kthyera mbrëmë nga Siria", dhe pretendimin se shkrimi bënë shkelje të Kreut II pika 3 dhe Kreut VII pika 1 të Kodit të Mediave të Shkruara

Lajmi është shkruar në portal dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës KMShK gjen se ankesa është e bazuar. Për shkak se paraqet shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës) pika 3 dhe Kreut VII (Privatësia) pika 1 të Kodit të Mediave të Shkruara.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës